

NJOFTIME TË TJERA

KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE

NJOFTIMI I PROCEDURËS KONKURRUESE

Zhvilluesi i Projektit të Investimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projektit të Investimit:	Korpusi i Inspektorateve dhe Shtëpia e re e fëmijëve “Zyber Hallulli”
Përzgjedhja e zhvilluesit dhe konkursi i projektimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Titulli i kontratës:	Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i objektit multi-funksional në Rugën e Elbasanit, Tiranë

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu “Korporata”, është një shoqëri tregtare aksionere, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksioner të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.
2. Korporata, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 31.7.2025, “Për transferimin të Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit “Korpusi i Inspektorateve” dhe projekteve të tjera të investimit” është autorizuar për të vepruar si zhvilluese e këtij projekti investimi.
3. Projekti i investimit realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e zhvilluesit të pronave shtetërore në pronësi të saj dhe partnerëve publikë, përfitues në këtë projekt dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe ekzekutive, dhe ka interes në realizimin e projektit të investimit. Projekti do të realizohet nëpërmjet instrumentit të sipërmarrjes, ku partneri privat do të financojë ndërtimin e dy objekteve publike, Korpusit të Inspektorateve dhe Shtëpisë së re të fëmijëve “Zyber Hallulli”, në këmbim të pjesës takuese të Korporatës në objektin multifunksional që zhvillohet pronën e Korporatës në Rugën e Elbasanit, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 459/2025.
4. Korporata zhvillon këtë procedurë konkurruese në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), e cila duke përdorur ekselencën e saj disa vjecare ka përgatitur termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit për projekt-idetë arkitekturore që do të propozohen nga aplikantët për këtë projekt, të cilat mund të konsultohen në Seksionin IV, nën-seksioni 2,

"Termat e Referencës për projekt-identë arkitekturore", të Dokumentit të Kualifikimit.

5. Konkurrimi për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës konkurruese përzgjedhëse me pikëzim, me 2 (dy) faza/3 (tre) zarfa, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në "Rregulloren për Procedurën e Konkurrimit", të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës, link. Procedura është e hapur për të gjithë subjektet, persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendas apo të huaj.
6. Aplikantët mund të aplikojnë në bashkëpunim me Nënkontraktorë të Specializuar të përzgjedhur nga vetë ata. Aplikantët mund të përdorin kualifikimet e Nënkontraktorëve të Specializuar, për të plotësuar kushtet e kualifikimit në lidhje me shërbime të lidhura apo pjesë të kontratës, në përputhje me përcaktimet për "Nënkontraktorët e Specializuar" në Seksionin I, Udhëzimet për Aplikantët në Dokumentin e Kualifikimit dhe Seksionin IV, nën-seksioni 4, Nënkontraktorët e Specializuar, të Dokumentit të Kualifikimit.
7. Dokumenti i Kualifikimit është i hartuar në gjuhët shqip dhe anglisht dhe është publikuar në faqen e internetit të Korporatës, link.
8. Faza e kualifikimit (Faza I) konsiston në paraqitjen e një aplikimi nga subjektet e interesuara, aplikim i cili përmban 2 projekt-identë paraprake arkitekturore dhe dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kualifikimit të aplikantëve.
9. Faza e përzgjedhjes (Faza II) konsiston në paraqitjen e një propozimi, i cili përmban dy zarfa të ndarë: (a) zarfi i parë përmban 2 projekt-ide arkitekturore dhe (b) zarfi i dytë përmban ofertën financiare, sic detajohet në Ftesën për Propozim. Kjo fazë synon përzgjedhjen e projekt-idesë arkitekturore dhe të propozimit financiar më të favorshëm për Korporatën të paraqitur nga një partner i kualifikuar.
10. Ky Njoftim i Procedurës Konkurruese hap fazën e parë të procedurës konkurruese për përzgjedhjen e Partnerit. Në këtë fazë do të kualifikohen kandidatët e renditur në 5 vendet e para, të cilët:
 - a. plotësojnë kriteret e kualifikimit;
 - b. do të paraqesin projekt-identë paraprake arkitekturore të projektit, e cila renditet në 5 (pesë) projekt-identë më të vlerësuar;
 - c. marrin përsipër, nëse përzgjidhen, të plotësojnë angazhimet si vijon, të cilat përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së sipërmarrjes:
 - i. angazhimin për pagesën e shpenzimeve të konkursit ndërkombëtar të përzgjedhjes së projekt - idesë arkitekturore për projektin;
 - ii. angazhimin për pagesën e vlerës së projektit të detajuar arkitekturor të koncept idesë fituese të konkursit;
 - iii. angazhimin që objekti i parë i ndërtuar në projekt do të jetë Shtëpia e re e Fëmijëve "Zyber Hallulli" në zonën në vilat gjermane (me kërkesë të Korporatës);
 - iv. angazhimin për sistemimin në ambiente pune të përshtatshme, të punonjësve të institucioneve publike që aktualisht punojnë në pronat objekt i këtij projekti investimi, për të gjithë periudhën e ndërtimit, deri në dorëzimin e pronës për zhvillim publik (me kërkesë të Korporatës);
 - v. angazhimin për pagesën e vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të

- aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi, mbikëqyrjen e punimeve apo çdo fazë të zhvillimit të pronës deri në regjistrimin e pronës së zhvilluar;
- vi. angazhimin për regjistrimin e objekteve të reja dhe kalimin e pjesëve takuese të partnerit publik/Korporatës me shpenzimet e partnerit privat;
 - vii. angazhimin që me kërkesë të Korporatës, nga pjesa takuese e Korporatës në objektin për sipërmarrje të ndërtuar në pronën e Korporatës në Rugën e Elbasanit, Tiranë, të zhvillojë plotësisht projektin arkitekturor të godinës së Korpusit të Inspeksioneve dhe të zhvillojë projekt-idenë arkitekturore të Shtëpisë së re të fëmijëve “Zyber Hallulli” në pronat përkatëse;
 - viii. angazhimin për të lidhur me Korporatën kontratën e sipërmarrjes dhe marrëveshjeve shoqëruese të saj, në përfundim të procesit të përzgjedhjes.
11. Vetëm kandidatët e kualifikuar në fazën e parë do të ftohen në fazën e dytë të konkurrimit nëpërmjet dërgimit të Ftesës për Propozim. Faza e dytë e përzgjedhjes së kandidatit fitues për kontratën konsiston në paraqitjen e një propozimi që përmban 2 (dy) pjesë, projekt idenë arkitekturore (zarfi 1) dhe ofertën financiare (zarfi 2). Ofertat financiare të paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është 45% (dyzet e pesë përqind) e sipërfaqes totale të zhvillimit të objektit multifunksional në pronën e Korporatës në Rugën e Elbasanit, Tiranë.
12. Vlerësimi i propozimit kryhet në dy etapa nëpërmjet një konkursi të hapur publik në praninë e një jurie ndërkombëtare. Në etapën e parë vlerësohen projekt-idetë arkitekturore dhe jepen çmimet për 5 projekt-idetë e propozuara arkitekturore për një sipërfaqe maksimale për t’u projektuar prej rreth 60,000 metra katrorë. Në etapën e dytë vlerësohen ofertat financiare në zbatim të metodologjisë së përzgjedhjes së kandidatit fitues të kontratës përcaktuar në Seksionin II, pikat 6 dhe 7, të Dokumentit të Kualifikimit, ku vlen të theksohet se kriteri përzgjedhës është:
- a. përqindja më e lartë e sipërfaqjes së ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë, të përlllogatitur mbi sipërfaqjen totale të metrave katrorë të objektit multifunksional të zhvilluar në pronën e Korporatës në Rugën e Elbasanit, Tiranë.
13. Kontrata fitohet nga kandidati që është vlerësuar nga Juria me çmimin e parë të projekt-idesë arkitekturore, nëse ka paraqitur një ofertë financiare, me përqindjen më të lartë për Korporatën, mbi kriterin bazë, sipas përcaktimeve të kriterit përzgjedhës. Në kontratë, partneri privat merr përsipër që me kërkesë të Korporatës, nga pjesa takuese e saj në objektin për sipërmarrje të ndërtuar në pronën e Korporatës në Rugën e Elbasanit, Tiranë, të zhvillojë plotësisht projekt-idetë arkitekturore të godinës së Korpusit të Inspeksioneve dhe Shtëpisë së re të fëmijëve “Zyber Hallulli”.
14. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00 - 17:00 ora lokale apo në adresën e emailit: competition@aicorporation.al
15. Aplikimet duhet të përgatiten dhe dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentat shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht duhet të përkthehen në njëren nga këto gjuhë.
16. Aplikimet mund të dorëzohen elektronikisht me email, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri në datë 15 Tetor 2025, ora 15:00, ora lokale. Hapja e aplikimeve do të bëhet

menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtëme:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

E-mail: competition@aicorporation.al

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>